

VENDIM
Nr. 66, datë 11.5.2015

MBI FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “GAMA ENERGY” SHPK, NË AKTIVITETIN E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC “LENA 1”, “LENA 2” DHE “LENA 2A”, ME FUQI TË INSTALUAR, PÛRKATËSISHT 1.95, MW; 2.3 MW DHE 0.25 MW (FUQI TOTALE 4.5 MW)

Në mbështetje të neneve 8, pika 2, germa “a”; 9 dhe 13, pika 1, germa “a”, të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 4, pika 1, germa “a”; 8, 9 dhe 10, pikat 1 dhe 3, të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008, Bordi i Komisionerëve i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 11.5.2015, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Gama Energy” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe të Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe të Mbrojtjes së Konsumatorit për licencimin në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie nga HEC “Lena 1”, “Lena 2” dhe “Lena 2A”,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Gama Energy” sh.p.k., plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

Neni 9, pika 1. Format i aplikimit është plotësuar në mënyrë korrekte.

Neni 9, pika 2. Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor është plotësuar tërësisht.

Neni 9, pika 3. Dokumentacioni financiar dhe fiskal është plotësuar tërësisht.

Neni 9, pika 4.1.1. Është plotësuar pjesërisht.

Neni 9, pika 4.1.2. Është plotësuar tërësisht.

Neni 9, pika 4.1.3. Është plotësuar tërësisht.

Neni 9, pika 4.1.4. Dokumentacioni teknik-ekonomik është plotësuar tërësisht.

Neni 9, pika 4.1.5. Leje nga institucione të tjera. Është plotësuar pjesërisht.

Është në proces miratimi i pikës se lidhjes me rrjetin e shpërndarjes.

Për dokumentacionet e munguara do të njoftohet subjekti që në bazë të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, neni 10, pika 10, dhe neni 11, pika 1, t’i paraqesë këto në ERE brenda afateve.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve i ERE-s

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave për licencimin e shoqërisë “Gama Energy” sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Lena 1”, “Lena 2” dhe “Lena 2A”, me fuqi të instaluar, përkatësisht 1.95 MW, 2.3 MW dhe 0.25 MW (fuqi totale 4.5 MW).

2. Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojnë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti